

Nëntë parime për pastrimin e shpirtit

1. *Pastrimi i shpirtit është në Dorën e Allahut.* Askush nuk mund të pastrohet shpirtërisht përveç atij të cilin Allahu e ka pastruar. Allahu thotë: **“Allahu dëlirë kë të dojë”**. Nisa 49. **“Allahu jua ka bërë të dashur besimin dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ashtu siç jua ka bërë të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen. Pikërisht ata janë të udhëzuarit drejt me mirësinë dhe hirin e Allahut. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.** Huxhurat 7-8.

2. Të bëhet lutje tek Allahu për pastrimin e shpirtit, vazhdimisht. Nevoja e njeriut për t'iu drejtuar Allahut me lutje, të Vetmit, i Cili pastron shpirtat, është shumë e madhe. Lutja është çelësi i çdo mirësie të të dy botëve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është lutur: **"O Allah, jepi shpirtit tim devotshmërinë, pastroje atë ngase Ti më së miri e pastron atë! Ti je Kujdestari dhe Mbrojtësi i shpirtit tim!"** Muslimi.

3. *Baza e pastrimit të shpirtit është teuhidi- njëshmëria e Allahut.* Teuhidi për pastrimin e shpirtit është sikur rrënja për pemën. Nuk ka mundësi të qëndrojë i fortë pastrimi i shpirtit pa teuhidin. Allahu thotë: **"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli?"** Ibrahim 24. Kështu është çështja me teuhidin kur vendoset në zemrën e

besimtarit. Pema e pastrimit të shpirtit qëndron mbi rrënjët e teuhidit. Nëse personi nuk ka teuhid, nuk ka mundësi as ta dëlirë shpirtin e tij.

4. *Burimi i dëlirjes shpirtërore është gjithashtu Kurani.* Sa më shumë që njeriu është i lidhur me Kurandin, duke e lexuar shpesh e shumë dhe duke meditaruar rreth kuptimeve të tij, si dhe duke punuar me të, aq më shumë do të ketë hise në pastrimin dhe dëlirjen e shpirtit të tij. Allahu thotë: **“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kurandin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare)...”** Ali Imran 164.

5. Nuk ka pastrim të shpirtit përveçse me pasim ndaj Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Pejgamberët janë shembull për ata që duan dëlirje shpirtërore. Imami i të gjithë Pejgamberëve, Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, duhet të jetë shembull për ne edhe në këtë pikë që po e diskutojmë, **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë”**. Ahzab 21. Dikush mundohet ta dëlirë shpirtin e tij pa e ndjekur Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem, mirëpo e ndjekë dikë tjetër. Kjo dhe është një gjë e paarritshme. Ai salAllahu alejhi ue selem na ka dhënë një parim përmbledhës në këtë hadith: **“Kush vepron një vepër e cila nuk është e bazuar në fenë tonë, ajo është e refuzuar.”** Edhe dëlirja shpirtërore nëse nuk është e bazuar në fenë tonë, nuk arrihet (refuzohet).

6. *Rrugët e shpikura për dëlirje shpirtërore të pabazuara në sunetin profetik, nuk pastrojnë shpirtin.* Përkundrazi, i dërgojnë njerëzit larg dëlirjes shpirtërore. Këto rrugë të shpikura, që i përdorin për të arritur dëlirjen e shpirtit, të gjitha janë bidate, si: vetmimi diku në një vend me errësi, duke shkëputur lidhjet me njerëz dhe duke mos bërë as namaz me xhemat, as xhumah, as marrje të dijes te njerëzit e dijes, si dhe duke përsëritur disa fjalë të caktuara (edhe nëse nuk ua dinë kuptimin), kjo për disa ditë apo javë të caktuara. E gjithë kjo është lojë e shejtanit. Apo metodë tjetër siç pretendojnë disa të tjerë është ndalimi prej disa ushqimeve të caktuara. Porse këto rrugë veçse i kanë larguar më shumë prej pastrimit të vetes.

7. *Duhet përmbajtur rrugës së mesme në dëlirjen shpirtërore, pra drejtësisë dhe mesatares.* Allahu thotë: **“Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë (mesatare)...”** Bekare 143. Umeti islam është i mesëm në të gjitha çështjet e fesë, as nuk kalon në ekstrem e as në neglizhencë. Nëse besimtari bën adhurime duke dashur të pastrojë nëpërmjet tyre shpirtin e tij, apo pajiset me moral për të pastruar shpirtin, atëherë patjetër në këto duhet t'i përmbahet rrugës së mesme. Kjo do të thotë: t'i përmbahet rrugës së vërtetë, të drejtë, e cila është suneti i Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Drejtësia është në sunetin e tij.

8. *Dëlirja shpirtërore ka kuptimin e zbrazjes dhe mbushjes.* Njeriu nuk ka mundësi ta pastrojë shpirtin e tij veçse përmes këtyre dy gjërave: zbrazjes së shpirtit prej veseve e tipareve të këqija dhe mbushjes (zbukurim) me tipare të mira. Fjala tezkija (pastrim i shpirtit) në gjuhën arabe nënkupton: shtim dhe pastrim. Shtim të veprave të mira, pastrim prej të metave, mëkateve, moraleve e veseve të këqija. Prej ajeteve se tezkije ka kuptimin e mbushjes dhe stolisjes së shpirtit tonë me tipare e morale të mira, është: **"I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!"** Ale 14- 15. Dhikri, namazi, në përgjithësi adhurimet e pastrojnë shpirtin tonë. Ndërsa, prej ajeteve që tregojnë se tezkije është largimi prej mëkateve e gjërave të ulëta etj., është ajeti: **"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)!"** Nur 30.

9. Njeriu t'ia kujtojë vetes gjithmonë Ditën e Gjykimit, kur do të qëndrojë para Allahut dhe do të japë llogari tek Ai për veprat e bëra. Nëse ia kujton këtë vetes gjatë ditës, kjo do të ndihmojë shumë në dëlirjen e shpirtit. Allahu thotë: **"Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari."** Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur..." Hakka 20-21. Sa më shumë që ky kujtim e shoqëron njeriun, kjo do të jetë shkak për frenimin e vetes nga gjërat e këqija dhe mëkatet dhe do ta dërgojë drejt vlerave dhe virtyteve të mira. Allahu thotë: **"O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të**

shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” Hashr 18. “O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.” Tahrim 6. “Dhe ruajuni asaj Dite që do të ktheheni tek Allahu, kur çdokujt do t’i jepet ajo që ka fituar dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.” Bekare 281.

Hoxhë Lulzim Perçuku – Dersi “*Nëntë parime për pastrimin e shpirtit*”.